REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 316, Datë 26.10.2026

MBI

FILLIMIN E PROCEDURËS ADMINISTRATIVE PËR SHQYRTIMIN DHE MIRATIMIN E RREGULLORES "PËR PROCEDURAT, DOKUMENTACIONIN DHE AFATET PËR DHËNIEN E AUTORIZIMIT NGA ERE PËR NDRYSHIMIN E STATUSIT LIGJOR TË TË LICENCUARIT, NDRYSHIMIN E KONTROLLIT TË TË LICENCUARIT DHE VENDOSJEN E KUOTAVE/AKSIONEVE SI GARANCI"

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 59/2026 "*Për sektorin e energjisë elektrike*", dhe nenit 26 të *Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s*, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 26.10.2026, pasi shqyrtoi relacionin nr. 3182 prot., datë 26.10.2026 të përgatitur nga Grupi i Punës "*Mbi fillimin e procedurës administrative për shqyrtimin dhe miratimin e "Rregullores për procedurat, dokumentacionin dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e kontrollit të të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve si garanci*",

Konstatoi se:

- Në zbatim të Urdhrit të Kryetarit të ERE-s nr. 137, datë 18.08.2026, është ngritur Grupi i Punës për hartimin dhe rishikimin e akteve rregullatore që lidhen me licencimin dhe ushtrimin e veprimtarive të licencuara, në kuadër të zbatimit të ligjit nr. 59/2026 "Për sektorin e energjisë elektrike". Në përmbushje të detyrave të përcaktuara në këtë urdhër, Grupi i Punës ka hartuar projekt-rregulloren për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për dhënien e autorizimeve nga ERE, me qëllim përshtatjen e kuadrit rregullator me dispozitat e ligjit të ri.
- Projekt-Rregullorja synon të përcaktojë në mënyrë të strukturuar dokumentacionin, afatet dhe kriteret e shqyrtimit të kërkesave që lidhen me ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e kontrollit të të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve si garanci, në rastet kur kërkohet autorizimi i ERE-s.
- Përcaktimi i fazave të procedurës dhe i rolit të strukturës përgjegjëse synon të mbështesë një shqyrtim të njëtrajtshëm, transparent dhe të dokumentuar të kërkesave, si dhe arsyetimin e vendimmarrjes së bordit.
- Projekt-rregullorja është e zbatueshme në sektorin e energjisë elektrike dhe është konceptuar si akt i ri, që zëvendëson rregulloren e miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 235, datë 26.11.2021. Dispozitat e "*Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimeve ndaj të tretëve"*, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 235, datë 26.11.2021, që lidhen me sektorin e gazit natyror, vazhdojnë të zbatohen për këtë sektor deri në miratimin e një akti të ri ose ndryshimin e tyre nga bordi i ERE-s, për aq sa janë në përputhje me ligjin nr. 102/2015 "*Për sektorin e gazit natyror*", i ndryshuar, dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore në fuqi. Kjo rregullore nuk rregullon dhe nuk shfuqizon procedurat e zbatueshme për sektorin e gazit natyror.
- Përpara miratimit përfundimtar, projekt-rregullorja do t'i nënshtrohet procedurave të konsultimit dhe shqyrtimit të parashikuara nga legjislacioni në fuqi dhe rregullat e ERE-s.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën administrative për shqyrtimin dhe miratimin e "*Rregullores për procedurat, dokumentacionin dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e kontrollit të të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve si garanci*", sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Projekt-rregullorja t'i nënshtrohet procesit të publikimit dhe konsultimit me palët e interesit, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe procedurat e përcaktuara nga ERE për miratimin e akteve rregullatore.
3. Ngarkohet Grupi i Punës i ngritur me Urdhrin e Kryetarit të ERE-s nr. 137, datë 18.08.2026, për ndjekjen e procedurës administrative, publikimin e projekt-rregullores, zhvillimin e konsultimit me palët e interesuara, administrimin dhe shqyrtimin e komenteve dhe propozimeve të paraqitura, si dhe përgatitjen e relacionit përfundimtar dhe të projekt-rregullores së rishikuar për shqyrtim nga bordi i ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s rishikimin e vendimit brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, në rast se ka siguruar prova të reja që mund të çojnë në marrjen e një vendimi të ndryshëm ose në rast të gabimeve materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare. Paraqitja e ankimit nuk pezullon vlefshmërinë e vendimit, përveçse kur gjykata vendos ndryshe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Miratuar me Vendimin e bordit të ERE-s. Nr. 316, Datë 26.10.2026

Projekt-RREGULLORE

PËR PROCEDURAT, DOKUMENTACIONIN DHE AFATET PËR DHËNIEN E AUTORIZIMIT NGA ERE PËR NDRYSHIMIN E STATUSIT LIGJOR TË TË LICENCUARIT, NDRYSHIMIN E KONTROLLIT TË TË LICENCUARIT DHE VENDOSJEN E KUOTAVE/AKSIONEVE SI GARANCI

Autoriteti

Kjo rregullore hartohet në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 59/2026, "Për sektorin e energjisë elektrike", dhe të nenit 13 të ligjit nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror", i ndryshuar, përkatësisht për subjektet dhe veprimtaritë që i nënshtrohen këtyre ligjeve. Për procedurat administrative zbatohen gjithashtu dispozitat e ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", dhe të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016.

Neni 2
Objekti

1. Kjo rregullore përcakton procedurat, dokumentacionin, kriteret e shqyrtimit dhe afatet për dhënien nga ERE të autorizimit për:

a) ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, përfshirë transformimin, bashkimin, ndarjen ose riorganizimin, kur veprimi ndikon në subjektin që mban licencën ose në përmbushjen e kushteve të saj;

b) ndryshimin e drejtpërdrejtë ose të tërthortë të ortakut/aksionerit që kontrollon të licencuarin;

c) vendosjen e kuotave/aksioneve si peng, barrë ose garanci tjetër, kur ekzekutimi i garancisë mund të sjellë ndryshim të kontrollit të të licencuarit.

2. Kjo rregullore nuk zëvendëson miratimet, njoftimet ose regjistrimet që kërkohen nga legjislacioni për shoqëritë tregtare, koncesionet, konkurrencën, investimet ose nga autoritete të tjera kompetente.

Neni 3
Qëllimi dhe parimet

1. Qëllimi i rregullores është të sigurojë që ndryshimet e parashikuara në nenin 1 të mos cenojnë aftësinë e të licencuarit për të ushtruar veprimtarinë e licencuar, përmbushjen e detyrimeve ligjore e rregullatore, sigurinë dhe vazhdimësinë e shërbimit, si dhe interesat e klientëve dhe funksionimin e tregut.

2. Procedura zhvillohet mbi bazën e ligjshmërisë, objektivitetit, proporcionalitetit, transparencës, trajtimit të barabartë, konfidencialitetit të informacionit të mbrojtur dhe arsyetimit të vendimmarrjes.

Neni 4
Fusha e zbatimit

1. Rregullorja zbatohet ndaj subjekteve të licencuara nga ERE në sektorin e energjisë elektrike dhe, për çështjet që mbulohen nga legjislacioni përkatës, ndaj subjekteve të licencuara në sektorin e gazit natyror.

2. Kur për sektorin e gazit natyror ligji ose aktet e posaçme parashikojnë procedurë të ndryshme, zbatohen dispozitat e posaçme. Asnjë dispozitë e kësaj rregulloreje nuk interpretohet si zgjerim i kompetencave të ERE-së përtej autorizimit ligjor.

Neni 5
Përkufizime

Për qëllimet e kësaj rregulloreje:

a) "ERE" është Enti Rregullator i Energjisë;

b) "Bordi" është organi vendimmarrës i ERE-së;

c) "i licencuar" është personi fizik ose juridik që mban licencë të lëshuar nga ERE;

ç) "kontroll" është mundësia për të ushtruar ndikim përcaktues mbi vendimmarrjen e një shoqërie, nëpërmjet pronësisë, të drejtave të votës, marrëveshjeve ose mjeteve të tjera juridike;

d) "ndryshim i kontrollit" është çdo ndryshim i drejtpërdrejtë ose i tërthortë që sjell një kontrollues të ri ose ndryshon personin/personat që ushtrojnë ndikim përcaktues mbi të licencuarin;

dh) "aplikant" është i licencuari ose përfaqësuesi i tij i autorizuar që paraqet kërkesën;

e) "dokumentacion i plotë" është dokumentacioni i kërkuar nga kjo rregullore dhe informacioni shtesë i arsyetuar që ERE kërkon në mënyrë të ligjshme për shqyrtimin e kërkesës.

ë) "transferim kuotash/aksionesh" është është çdo veprim me anë të të cilit krijohet një marrëdhënieje shitjeje, dhurimi, dhënieje me qira, transferimi, hipotekimi, barre ose çfarëdolloj disponimi tjetër i kuotave apo aksioneve të të licencuarit, kur nga ky transferim ndryshon ortaku/aksionari që kontrollon interesat e të licencuarit.

f) "Ortaku/aksionari që kontrollon interesat e të licencuarit" është ortaku apo aksionari që zotëron përqindjen e nevojshme për të përcaktuar vendimmarrjen në shoqërinë e licencuar. Për çfarëdolloj transferimi kuotash apo aksionesh që ndryshon këtë përqindje është e nevojshme të merret autorizimi nga ERE.

PJESA II
PARAQITJA E KËRKESËS DHE DOKUMENTACIONI

Neni 6
Paraqitja dhe forma e kërkesës

1. Kërkesa paraqitet me shkrim në ERE nga përfaqësuesi ligjor i të licencuarit. Ajo nënshkruhet nga personi/personat që kanë të drejtë përfaqësimi, sipas regjistrit tregtar dhe dokumenteve të shoqërisë.

2. Kërkesa përmban: emërtimin dhe NUIS-in e të licencuarit; adresën dhe të dhënat e kontaktit; numrin dhe objektin e licencës; llojin e autorizimit të kërkuar; përshkrimin e veprimit të propozuar; arsyet dhe datën e parashikuar të realizimit; identifikimin e palëve të përfshira; ndikimin e pritshëm në aktivitetin e licencuar; si dhe listën e dokumenteve bashkëlidhur.

3. Nëse kërkesa paraqitet nga përfaqësuesi, bashkëlidhet prokura ose akti i vlefshëm i përfaqësimit.

4. Dokumentet paraqiten në gjuhën shqipe. Dokumentet e huaja shoqërohen me përkthim zyrtar dhe, kur kërkohet nga legjislacioni, me legalizim ose apostilë. Dokumentet elektronike pranohen kur plotësojnë kërkesat ligjore për nënshkrimin dhe vlefshmërinë elektronike.

5. Aplikanti identifikon veçmas informacionin që pretendon se është konfidencial dhe arsyeton kërkesën. ERE e vlerëson këtë kërkesë sipas legjislacionit përkatës; shënimi i një dokumenti si konfidencial nuk sjell automatikisht kufizimin e aksesit.

Neni 7
Dokumentacioni për ndryshimin e statusit ligjor

Përveç dokumenteve të përgjithshme të nenit 6, kërkesa shoqërohet me:

a) ekstraktin historik dhe aktual të regjistrit tregtar të të licencuarit;

b) vendimin e organit kompetent të shoqërisë për ndryshimin e propozuar dhe dokumentet e projektit të riorganizimit, kur zbatohen;

c) përshkrimin e pasojave të ndryshimit për licencën, asetet, detyrimet, kontratat, strukturën drejtuese dhe vazhdimësinë e aktivitetit të licencuar;

ç) planin dhe afatin e zbatimit, duke përfshirë masat për të shmangur ndërprerjen e aktivitetit ose cenimin e shërbimit;

d) konfirmimin se pas ndryshimit do të vazhdojnë të përmbushen kushtet e licencës dhe detyrimet ndaj ERE-së;

dh) miratimet ose njoftimet e autoriteteve të tjera, kur kërkohen nga ligji.

Neni 8
Dokumentacioni për ndryshimin e kontrollit

1.Përveç dokumenteve të përgjithshme të nenit 6, kërkesa shoqërohet me:

a) strukturën aktuale dhe atë të propozuar të pronësisë, duke treguar zotërimin e drejtpërdrejtë dhe të tërthortë, përqindjet e kapitalit dhe të drejtave të votës, si dhe personat që ushtrojnë kontroll;

b) ekstraktet e regjistrit tregtar të të licencuarit, ortakëve/aksionerëve përkatës dhe personit të propozuar për të ushtruar kontroll, në rastet kur këta janë persona juridikë/fizikë;

c) marrëveshjen ose projektmarrëveshjen e transferimit, vendimet e organeve kompetente dhe pranimin e palës përfituese;

ç) informacionin mbi identitetin, pronësinë përfituese, veprimtarinë, përvojën dhe aftësinë financiare të kontrolluesit të propozuar, në masën që është e nevojshme për vlerësimin rregullator;

d) burimet e financimit të transaksionit dhe përshkrimin e kontributit financiar të parashikuar për vazhdimin e aktivitetit të licencuar;

dh) analizën e ndikimit të ndryshimit në përmbushjen e kushteve të licencës, investimet, detyrimet ndaj ERE-së, sigurinë dhe cilësinë e shërbimit;

e) miratimin/njoftimin e autoritetit tjetër kompetent, kur kërkohet;

ë) deklaratën për saktësinë dhe plotësinë e informacionit të paraqitur.

f) deklaratë nga i licencuari se kuotat/aksionet për të cilat kërkohet transferimi nuk janë vendosur si mjete për garantimin e ndonjë detyrimi ndaj të tretëve

2.Kur kontrolli ushtrohet nëpërmjet një zinxhiri shoqërish, informacioni i pronësisë paraqitet deri te personi ose personat që ushtrojnë kontrollin përfundimtar, në masën e kërkuar në mënyrë të arsyetuar nga ERE.

Neni 9
Dokumentacioni për vendosjen e kuotave/aksioneve si garanci

Përveç dokumenteve të përgjithshme të nenit 6, kërkesa shoqërohet me:

a) vendimin e organit kompetent të të licencuarit;
b) ekstrakti historik i regjistrit tregtar të të licencuarit;

c) projektmarrëveshjen ose marrëveshjen me kreditorin, bankën ose përfituesin e garancisë;

ç) përshkrimin e detyrimit të garantuar, shumës, afatit, kushteve të ekzekutimit dhe pasojave të mundshme për kontrollin e të licencuarit;

d) analizën e skenarit të ekzekutimit të garancisë dhe masat që synojnë të sigurojnë vazhdimësinë e aktivitetit të licencuar;

dh) deklarimin e garancive ose barrëve të tjera që rëndojnë mbi të njëjtat kuota/aksione;

e) miratimet e tjera të kërkuara me ligj, nëse ka.

ERE vlerëson nevojën për autorizim paraprak duke marrë parasysh nëse dhe në çfarë kushtesh ekzekutimi i garancisë mund të sjellë ndryshim kontrolli. Kjo rregullore nuk interpretohet si ndalim i përgjithshëm i financimit ose i vendosjes së garancive që nuk kërkojnë autorizim sipas ligjit.

Neni 10
Detyrimet financiare dhe plotësia e aplikimit

1. ERE verifikon përmbushjen e detyrimeve të pagesave rregullatore në përputhje me ligjin dhe aktet në fuqi. Ekzistenca e detyrimeve të papaguara vlerësohet sipas bazës ligjore përkatëse dhe nuk përbën shkak automatik refuzimi përtej rasteve të parashikuara shprehimisht nga ligji.

2. ERE mund t'i kërkojë aplikantit informacion ose dokumentacion shtesë kur është i nevojshëm, relevant dhe proporcional për vlerësimin e kërkesës. Kërkesa për plotësim duhet të identifikojë dokumentin ose çështjen konkrete dhe arsyen e nevojës së tij.

PJESA III

SHQYRTIMI DHE VENDIMMARRJA

Neni 11
Regjistrimi dhe shqyrtimi paraprak

1. Brenda 5 (pesë) ditëve pune nga data e marrjes së kërkesës, struktura përgjegjëse e ERE-s kryen kontrollin paraprak të dokumentacionit, me qëllim verifikimin e pranisë së dokumenteve të kërkuara shprehimisht nga kjo rregullore.

2. Në rast se konstatohet se dokumentacioni është i paplotë, ERE njofton me shkrim aplikantin për mangësitë e evidentuara dhe i cakton një afat prej 10 (dhjetë) ditësh pune nga data e marrjes së njoftimit për plotësimin e tyre.

3. Në rast të mosdepozitimit të sa kërkuar brenda afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij neni, bordi I ERE-s merr vendim për mosfillimin e procedurës për aplikimin e paraqitur.

4.Në rast se konstatohet që dokumentacioni/informacioni i përcjellë në kuadër të marrjes së autorizimit, nuk është objekt i vendimmarrjes sç ERE-s sipas përcaktimeve të kësaj rregulloreje, Bordi i ERE-s do të shprehet nëpërmjet vendimarrjes përkatëse për mosmarrje në shqyrtim të kërkesës brenda një afati prej 10 (dhjetë) ditësh pune.

5. Pas administrimit të dokumentacionit të plotë, struktura përgjegjëse e ERE-s vijon shqyrtimin në themel të kërkesës, në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenin 12 të kësaj rregulloreje.

Neni 12
Kriteret e vlerësimit

Në shqyrtimin e kërkesës, ERE vlerëson, sipas natyrës së saj dhe në masën që lidhen me autorizimin:

a) përputhshmërinë e veprimit të propozuar me legjislacionin dhe kushtet e licencës;

b) identitetin dhe strukturën e pronësisë dhe kontrollit para dhe pas veprimit;

c) aftësinë e të licencuarit për të vijuar aktivitetin dhe për të përmbushur detyrimet ligjore e rregullatore;

ç) aftësinë financiare dhe organizative të kontrolluesit të propozuar, kur kjo është relevante;

d) ndikimin mbi sigurinë, vazhdimësinë dhe cilësinë e shërbimit, investimet dhe interesat e klientëve;

dh) rreziqet që mund të lindin nga ekzekutimi i garancive ose nga riorganizimi;

e) plotësinë, saktësinë dhe qëndrueshmërinë e informacionit të paraqitur;

ë) përmbushjen e miratimeve ose detyrimeve të tjera ligjore të zbatueshme.

Neni 13
Relacioni dhe propozimi për vendimmarrje

1. Në përfundim të shqyrtimit, struktura përgjegjëse përgatit relacionin për Bordin, ku pasqyrohen kërkesa, baza ligjore, faktet e konstatuara, dokumentacioni i shqyrtuar, vlerësimi sipas kritereve të nenit 12 dhe propozimi i arsyetuar për miratim, miratim me kushte ose refuzim.

2. Kur propozohet vendosja e kushteve, relacioni përcakton qëllimin, përmbajtjen, afatin dhe mënyrën e verifikimit të përmbushjes së tyre.

Neni 14
Vendimi i Bordit

1. Bordi vendos për miratimin, miratimin me kushte ose refuzimin e kërkesës, mbi bazën e ligjit, kësaj rregulloreje dhe dokumentacionit të administruar.

2. Vendimi duhet të përmbajë të paktën: identifikimin e aplikantit; objektin e kërkesës; bazën ligjore; përmbledhjen e fakteve dhe vlerësimit; dispozitivin; kushtet dhe afatet, kur ka; detyrimet pas vendimit; si dhe udhëzimin për mjetet ligjore të ankimit.

3. Refuzimi arsyetohet në mënyrë konkrete, duke identifikuar kërkesat ligjore ose rregullatore që nuk janë përmbushur dhe faktet që mbështesin përfundimin. Refuzimi nuk mund të mbështetet vetëm në konsiderata të përgjithshme ose në dokumente që nuk i janë bërë të njohura aplikantit, përveç kufizimeve të lejuara shprehimisht nga ligji.

4. Autorizimi i ERE-së nuk zëvendëson miratimin e autoriteteve të tjera dhe nuk përjashton detyrimin për të kryer regjistrimet përkatëse pranë organeve kompetente.

Neni 15
Afati i shqyrtimit

1. ERE shqyrton kërkesën brenda 30 ditëve pune nga data e paraqitjes së dokumentacionit të plotë, përveç rasteve kur ligji i posaçëm parashikon afat tjetër.

2. Kur kërkohen dokumente ose sqarime plotësuese, afati trajtohet sipas dispozitave të Kodit të Procedurave Administrative dhe njoftimit të ERE-së. Çdo pezullim ose rifillim i afatit dokumentohet në dosjen administrative dhe i njoftohet aplikantit.

3. Afati mund të zgjatet ose të pezullohet vetëm në rastet dhe sipas kushteve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi. Çdo vendim procedural përkatës arsyetohet, dokumentohet në dosjen administrative dhe i njoftohet aplikantit.

Neni 16
Njoftimi, publikimi dhe ankimi

1. Vendimi i njoftohet aplikantit dhe, kur kërkohet, autoritetit shtetëror përgjegjës ose autoriteteve të tjera kompetente.

2. Vendimi publikohet në faqen zyrtare të ERE-së dhe botohet në Fletoren Zyrtare kur një publikim i tillë kërkohet nga legjislacioni në fuqi. Publikimi respekton rregullat për informacionin konfidencial dhe të dhënat personale.

PJESA IV
DETYRIMET PAS AUTORIZIMIT DHE DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 17
Detyrimet pas dhënies së autorizimit

1. I licencuari depoziton në ERE dokumentet përfundimtare që provojnë kryerjen dhe regjistrimin e ndryshimit brenda 30 ditëve kalendarike nga realizimi i veprimit, përfshirë ekstraktin e përditësuar të regjistrit tregtar, kur është i zbatueshëm.

2. I licencuari njofton menjëherë ERE-n për çdo ndryshim material të fakteve ose dokumenteve mbi të cilat është dhënë autorizimi, si dhe për mosrealizimin e veprimit brenda afatit të autorizuar.

Neni 18
Regjistri i autorizimeve

1. ERE administron dhe publikon në faqen e saj zyrtare një regjistër të autorizimeve, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2. Regjistri përmban, së paku, emrin e të licencuarit, NUIS-in, llojin e autorizimit, numrin dhe datën e vendimit, si dhe statusin e autorizimit, kur ky informacion është publik.

3. Aksesi në dosjen administrative dhe trajtimi i informacionit konfidencial bëhen sipas legjislacionit në fuqi dhe rregullave të ERE-së për mbrojtjen e informacionit konfidencial.

Neni 19
Përgjegjësia për informacionin

Aplikanti mban përgjegjësi për vërtetësinë, saktësinë dhe plotësinë e informacionit dhe dokumenteve të paraqitura. Paraqitja e informacionit të rremë, fshehja e fakteve materiale ose mosnjoftimi i ndryshimeve relevante trajtohen sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 20
Dispozitë kalimtare

Kërkesat e paraqitura dhe të papërfunduara në datën e hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje shqyrtohen sipas dispozitave kalimtare të përcaktuara në vendimin e miratimit të saj. Në mungesë të një përcaktimi të posaçëm, veprimet procedurale të kryera rregullisht mbeten të vlefshme dhe procedura vijon në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

Neni 21
Shfuqizime

1.Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, shfuqizohet Rregullorja për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionerit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionerit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 235, datë 26.11.2021.

2. Dispozitat e Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimeve ndaj të tretëve, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 235, datë 26.11.2021, që lidhen me sektorin e gazit natyror, vazhdojnë të zbatohen për këtë sektor deri në miratimin e një akti të ri ose ndryshimin e tyre nga Bordi i ERE-s, për aq sa janë në përputhje me ligjin nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror", i ndryshuar, dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore në fuqi. Kjo rregullore nuk rregullon dhe nuk shfuqizon procedurat e zbatueshme për sektorin e gazit natyror.

Neni 22
Hyrja në fuqi

Kjo rregullore miratohet nga Bordi i ERE-s dhe hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

ANEKS 1

LISTË-KONTROLLI E DOKUMENTACIONIT PËR APLIKIMIN

Kjo listë shërben për lehtësimin e paraqitjes dhe kontrollit paraprak të dokumentacionit. ERE mund të kërkojë dokumente shtesë vetëm kur janë të nevojshme dhe të lidhura me objektin e kërkesës.

- Kërkesë e nënshkruar nga përfaqësuesi ligjor.
- Ekstrakti aktual dhe historik i regjistrit tregtar të të licencuarit.Kopje e licencës dhe identifikimi i veprimtarisë së licencuar.
- Vendimi i organit kompetent për veprimin e propozuar.
- Përshkrimi i transaksionit/ndryshimit dhe afati i realizimit.
- Struktura e pronësisë dhe kontrollit para dhe pas ndryshimit, kur zbatohet.
- Informacion për kontrolluesin e ri dhe burimin e financimit, kur është relevant.
- Marrëveshja ose projektmarrëveshja përkatëse.
- Informacion i ndikimit në vazhdimësinë e aktivitetit dhe përmbushjen e licencës.
- Informacioni për barrët/garancitë ekzistuese, kur zbatohet.
- Miratimet/njoftimet e autoriteteve të tjera, kur kërkohen.
- Prokura ose dokumenti i përfaqësimit, kur aplikimi paraqitet nga përfaqësues.
- Deklarata për vërtetësinë, saktësinë dhe plotësinë e informacionit.
- Lista e dokumenteve që kërkohet të trajtohen si konfidenciale dhe arsyetimi përkatës.